

# ANALIZË E QEVERISJES SË HAPUR TË KUVENDIT TË KOSOVËS

*PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES AKTUALE*

# ANALIZË E QEVERISJES SË HAPUR TË KUVENDIT TË KOSOVËS

## RRETH PUBLIKIMIT

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të projektit ‘Promovimi i Qeverisjes së Mirë 3.0’, mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) dhe zbatuar nga Open Data Kosova (ODK).

## AUTORE:

**Dafina Olluri dhe Delvina Haxhijaha**

## VERSIONET GJUHËSORE:

**ALB, ENG, SRB**

*Përfunduar në janar 2023 © ODK*

*Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED-it. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jo komerciale është i autorizuar, me kusht që burimi të dihet dhe botuesi të njoftohet paraprakisht dhe t’i dërgohet një kopje.*

## HYRJE

Transparenca legislative në një demokraci mund ta përmirësojë performancën parlamentare dhe ta rrisë angazhimin e qytetarëve për një shoqëri më të hapur dhe më transparente. Sipas analizës së realizuar nga ODK-ja ndër vite, e cila ka përcjellë dhe vlerësuar punën e hapur dhe transparencën e aktiviteteve të Kuvendit të Kosovës, ndërveprimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me qytetarët shërben si forca shtytëse pas përmirësimit të performancës.

Një organ legjislativ që është transparent në veprimet e tij është ai puna dhe veprimet e të cilit kuptohen nga audienca e përgjithshme dhe akterët përkatës. Kjo nënkupton që qytetarët duhet të kenë qasje në atë që e ka debatuar dhe prodhuar Kuvendi i tyre si dhe mundësi për të kërkuar informata. Prandaj, kjo analizë është përgatitur në mënyrë që të theksohet niveli i transparencës, puna e hapur institucionale dhe përgjegjshmëria e Kuvendit të Kosovës gjatë vitit 2021.

Për shumë vite, ODK-ja e ka përmirësuar vazhdimisht metodologjinë dhe treguesit e saj, duke iu përshtatur kërkesave të vitit përkatës. Ky dokument i politikës po ashtu e ofron një element krahasimtar ku ODK-ja e ka hartuar një analizë, duke përfshirë progresin e shfaqur gjatë viteve të fundit për Kuvendin e Kosovës. Ky dokument po ashtu synon t'i përforcojë parimet e qeverisjes së mirë dhe t'iu ndihmojë institucioneve t'i zbatojë ato në mënyrë më efektive në punën e tyre. Studimi mund të jetë i dobishëm për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, si dhe kolegëve nga sektori i OSHC-ve që merret me këto çështje. ODK-ja i ka respektuar parimet e transparencës në hulumtim dhe ia ka paraqitur të gjithë hollësitë dhe rezultatet e tij institucionit të vlerësuar. ODK-ja mbetet e hapur për çdo sugjerim, kritikë konstruktive dhe diskutim lidhur me këtë dokument të politikës.

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Katër parimet e mëposhtme udhëzuese kanë shërbyer si themel për këtë analizë, e cila ka monitoruar sa janë marrë të dhëna nga Indeksi Rajonal i Qeverisjes së Hapur lidhur me Kuvendin e Kosovës, mjet ky që vlerëson sa janë të qasshme institucionet qeveritare për publikun dhe shoqërinë në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Për Kuvendin e Kosovës, janë vlerësuar këto parime: 1) transparenca, 2) qasja, 3) integriteti dhe 4) ndërgjegjësimi. Këto parime janë vlerësuar në bazë të kriterëve në vijim: lehtësia e qasjes në informata në uebfaqet zyrtare të Institucionit; cilësia e kornizës legislative për temat përkatëse; burimet publike shtesë të informacionit; dhe pyetësorët e dorëzuar nga institucioni. Pas mbledhjes së të dhënave është përdorur një model i verifikimit të të dhënave, që ka rezultuar me gabimin standard prej +/- 3%. Vlerësimi është bërë nga qershori 2021 deri në fund të dhjetorit 2021. Bazuar në gjetjet e hulumtimit, është përpiluar një listë me rekomandime për institucionet.

Qasja e publikut në të dhënat organizative, buxhetet dhe proceset e prokurimit publik është e mandatuar me parimin e Transparencës. Qasja ka të bëjë me hartimin dhe zbatimin e politikave për qasje të pakufizuar në informacion, rritjen e qasjes në informacion përmes diskutimeve publike dhe promovimin e angazhimit të qytetarëve. Integriteti përfshin elementetsi lobimi, respektimi i kodit të etikës dhe luftimi i korrupsionit. Parimi i fundit, Ndërgjegjësimi, trajton monitorimin dhe vlerësimin e politikave të zbatuara nga institucionet.

Të gjitha katër parimet e lartpërmendura, si pjesë e Indeksit Rajonal të Qeverisjes së Hapur, ndihmojnë në përcaktimin, prezantimin dhe vlerësimin e punës dhe vullnetit të mirë politik drejt transparencës.

## **PUNA E HAPUR E KUVENDIT NË VITIN 2019**

Kuvendi i Kosovës shënoi një rezultat të përgjithshëm prej 80.5% sa i përket punës së hapur në vitin 2019. Ky rezultat tregon përmirësim të madh të këtij institucioni përgjatë viteve. Kur u vlerësua për herë të parë në vitin 2016, Kuvendi i Kosovës shënoi 60% në lidhje me treguesit dhe tani, rezultati tregon përmirësim për shkak të përpjekjeve që janë bërë ndër vite.

## **PUNA E HAPUR E KUVENDIT NË VITIN 2020**

Rezultatet e Kuvendit me kalimin e viteve kanë treguar përmirësim për shkak të përpjekjeve që janë bërë ndër vite – ku në vitin 2020 puna e hapur e Kuvendit u vlerësua me një rezultat prej 88%. Kuvendi i Kosovës shënoi 72% në parimin e qasjes, 91% në komponentin e ndërgjegjësim-it dhe 91% në parimin e transparencës.

## **PUNA E HAPUR E KUVENDIT NË VITIN 2021**

Kur u vlerësua për herë të parë në vitin 2016, Kuvendi i Kosovës shënoi 60% në lidhje me treguesit, ndërsa në vitin 2021, Kuvendi arriti një rezultat të përgjithshëm prej 86%. Në kapitullin në vijim do të jepet një shpjegim i hollësishëm i parimeve dhe rezultateve kryesore të Kuvendit në parimin e qasjes, ndërgjegjësimit, integritetit dhe transparencës.

## QASJA

Parimi i qasjes vlerëson shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve, OSHC-ve dhe akterëve të tjerë në punën e Kuvendit, duke përfshirë, mes tjerash, Aktin për Lirinë e Informacionit dhe rregulloret e tjera ekzistuese. Për vlerësimin e realizuar për vitin 2021, Kuvendi i Kosovës ka shënuar 69% në këtë parim – që nënkupton se ende nevojiten më shumë punë e përpjekje në të ardhmen për përmirësimin e këtij komponenti.

Siç është raportuar më herët në vlerësimet e bëra për Kuvendin, uebfaqja zyrtare e institucionit dhe faqja e tij në rrjetin social Facebook përditësohen në mënyrë aktive, duke publikuar njoftime rreth vendimeve, aktiviteteve dhe punës së Kuvendit<sup>1</sup>. Po ashtu, si pjesë e treguesit të Ndërgjegjësimit, metodologjia vlerëson edhe qasjen e Institucionit dhe përfshirjen e akterëve në punën e tij. Një pjesë e konsiderueshme e informatave/dokumenteve publike të Kuvendit publikohen vetëm në formate të mbyllura (PDF), gjë që ua bën të vështirë qytetarëve, hulumtuesve dhe organizatave të shoqërisë civile përpunimin e të dhënave të tilla, nxjerrjen e raporteve ose analizave të ndryshme. Prandaj, Kuvendi duhet t'i publikojë të gjitha informatat dhe dokumentet parlamentare në uebfaqen zyrtare në formate të hapura (Microsoft Excel ose Word).

Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se, në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, Kuvendi vazhdon ta ketë një person përgjegjës për menaxhimin e kërkesave për qasje në dokumente publike. Në këtë kontekst, uebfaqja e Kuvendit të Kosovës iu mundëson palëve të interesuara t'i shkruajnë letra deputetit të zgjedhur drejtpërdrejt për të diskutuar për ndonjë problem të veçantë me rëndësi për partinë<sup>2</sup>. E drejta për qasje në dokumente publike është zbatuar edhe me kornizën e Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), Komisioni i së cilës u emërua vitin e kaluar të vlerësimit. Kjo Agjenci është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në pajtim me këtë ligj, Agjencia i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për më tepër, ODK-ja dhe Kuvendi i Kosovës po vazhdojnë bashkëpunimin e tyre për krijimin e mjetit dixhital të njohur si E-pjesëmarrja, i cili do të mundësojë komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet publikut të gjerë dhe deputetëve.

Uebfaqja e Kuvendit përmban rregulla dhe procedura për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe/ose publikun e interesuar për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisioneve Parlamentare, duke kontribuar në përpjekjet e Institucionit për të qenë më i qasshëm ndaj palëve të interesuara<sup>3</sup>. Megjithatë, një mjet që mund ta rrisë edhe më tej angazhimin e qytetarëve në propozimin e politikave të reja publike është peticioni elektronik. Një mundësi e tillë për qytetarët do ta përmirësonte vlerësimin për qasjen e qytetarëve në Kuvend. Peticioni elektronik tani është edhe më i lehtë për t'u mundësuar me Ligjin për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike.<sup>4</sup>

1 [https://www.facebook.com/kuvendi.skupstina/?\\_rdc=1&\\_rdr](https://www.facebook.com/kuvendi.skupstina/?_rdc=1&_rdr)

2 <http://www.kuvendikosoves.org/#askDeputy>

3 [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2020\\_06\\_23\\_VendimidheRregullorjaperrendindheqasjenemediavedhetepublikutnepuneneKuvendit\\_CeARNKtVc4.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2020_06_23_VendimidheRregullorjaperrendindheqasjenemediavedhetepublikutnepuneneKuvendit_CeARNKtVc4.pdf)

4 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51618>

Si pasojë e mos funksionimit të këtij mjeti, Kuvendi ka marrë zero pikë në tre treguesit që kanë të bëjnë me peticionin elektronik. Megjithatë, procedura për pranimin dhe shqyrtimin e peticionit është përcaktuar me akt të veçantë dhe Kuvendi pritet ta miratojë Ligjin për Peticione. Peticioni elektronik vazhdon të mbetet një fushë premtuese për t'u përfshirë nga Kuvendi për sa i përket transparencës institucionale, pjesëmarrjes dhe angazhimit të qytetarëve.

Me qëllim të ofrimit të informacionit efikas dhe të saktë për palët e interesuara, Kuvendi investon kohë për të përfshirë personelin e tij në trajnime/edukime të ndryshme në fushën e qasjes në dokumente publike – siç është e paraparë me Ligjin për qasje në dokumentet publike (neni 28).<sup>5</sup> Personeli i Kuvendit të Kosovës raportohet të ketë marrë pjesë në një sërë sesionesh trajnuese, sipas anketës së realizuar me deputetët e Kuvendit të Kosovës, me qëllim të rritjes së njohurive të zyrtarëve publikë që punojnë me kërkesat për qasje në dokumente publike. Megjithatë, Agjencia për Informim dhe Privatësi duhet të bashkëpunojë me Institucionin për planifikimin dhe mbajtjen e sesioneve trajnuese për zyrtarët publikë në përputhje me ligjin e lartpërmendur.

Kuvendi i Kosovës vazhdon të mbajë marrëdhënie të mira me shoqërinë civile, siç parashihet edhe me rregulloren e punës së komisioneve parlamentare (Rregullorja e Punës, neni 65). Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës thotë se Komisionet mund të ftojnë në mbledhje edhe përfaqësues të institucioneve dhe agjencive tjera, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Për më tepër, në kuadër të Kuvendit funksionon Forumi për Transparencë Parlamentare, organ që përfshin edhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kanë role dhe përgjegjësi të barabarta vendimmarrëse me deputetët dhe anëtarët e tjerë të Forumit. Forumi i Transparencës është duke punuar për hartimin e Planit të Veprimit për Kuvend të Hapur 2023-2026, për ta promovuar kulturën e transparencës dhe për ta rritur llogaridhënien e Institucionit.

## NDËRGJEGJËSIMI

Në komponentin e Ndërgjegjësimit, Kuvendi i Kosovës ka shënuar 91%, rezultat ky që është përmirësuar me kalimin e viteve. Ky komponent lidhet me monitorimin dhe vlerësimin e politikave të realizuara brenda Kuvendit. Vlerësimi i ndikimit është i rëndësishëm, duke i mundësuar atij të përshkruajë raste të hartimit joefektiv të politikave dhe ligjeve.

Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, neni 66, komisionet kanë të drejtë të konsultohen me ekspertë për të marrë informata për një temë që është duke u debatuar. Komisionet parlamentare kanë vazhduar të kërkojnë këshilla dhe informata për çështje të caktuara nga ekspertë të jashtëm përmes vlerësimeve dhe konsultimeve.

<sup>5</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2050>

Ka vazhduar edhe përfshirja e ekspertëve të pyetur në seancat e hapura, duke e mbajtur publikun të informuar për ndryshimet që kanë të bëjnë me aktivitetet e Kuvendit që kanë ndikim në jetën e tyre të përditshme. Për më tepër, incizimet e proceseve parlamentare, duke përfshirë seancat, vihen në dispozicion të publikut dhe po ashtu arkivohen. Kjo i plotëson edhe kërkesat e parimit të ndërgjegjësisë, duke i ndërgjegjësuar palët e interesuara dhe duke i informuar për punën e Kuvendit.

Për këtë periudhë të vlerësuar, si pjesë e nën-sektorit të monitorimit parlamentar, përfaqësuesit e Ekzekutivit vazhdojnë të jenë përgjegjës për pjesëmarrjen dhe mund të sillen në Kuvend për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Përveç kësaj, ekziston një procedurë për të sjellë Mocion Vetëbesimi. Një grup parlamentar ose deputetët po ashtu mund të dorëzojnë petition për interpelancë për t'i kërkuar qeverisë apo një ministrie ta marrë parasysh një çështje të caktuar.

Sipas rezultateve për këtë periudhë, ekzistojnë disa mekanizma të vlerësimit të ndikimit rregullator (VNR), ndonëse ato rrallë aplikohen në punën e Kuvendit dhe në rregulloret e hartuara. Sa i përket planifikimit strategjik, Kuvendi ka bërë zhvillime pasi që i vlerëson ndikimet që mund të vijnë si rezultat i akteve ligjore ekzistuese dhe është i përgatitur për ta përmirësuar dhe lehtësuar punën.

## INTEGRITETI

Integriteti përfshin parimet dhe rregulloret për parandalimin e korrupsionit, zbatimin e kodit të etikës dhe rregulloret e lobimit. Në këtë parim, Kosova shënoi 95%.

Kosova ka zbatuar Kodin e Etikës për Deputetët me qëllim të luftimit efektiv të korrupsionit. Kodi i mirësjelljes dhe konflikti i interesit është pjesë e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit<sup>6</sup>. Rregullorja e re e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 129, parasheh miratimin e Kodit të Mirësjelljes, si akt i veçantë i Kuvendit. Ky akt rregullon çështjet që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, përdorimin e pronës shtetërore, dhuratat dhe favoret dhe veprimet politike. Kodi urdhëron që të gjitha interesat financiare dhe dhuratat që mund t'i marrin deputetët ose familjarët e tyre të afërt duhet t'i raportohen me shkrim Kryetarit të Kuvendit. Kjo deklaratë me shkrim duhet të dorëzohet në zyrën e Kryetarit të Kuvendit brenda tridhjetë (30) ditëve pas mbledhjes së parë të Kuvendit dhe duhet të rishikohet sa herë që ndodh ndonjë ndryshim i madh. Me qëllim të monitorimit të respektimit të kodit të etikës nga deputetët, Kuvendi pritet ta miratojë Kodin e Mirësjelljes për deputetët e Kuvendit. Për hartimin e tij është krijuar një grup i posaçëm punues.

<sup>6</sup> [http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/03\\_L-111\\_shqip.pdf](http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/03_L-111_shqip.pdf)

Deputetët në Kosovë vazhdojnë së deklaruar pasurinë, asetet, të hyrat dhe borxhet që janë të detyruar ta deklarojnë pasurinë e tyre. Lista e asetëve për deputetët e Kuvendit përfshin informacione të përditësuara mbi pasurinë, burimet e të ardhurave, shumën e të ardhurave dhe detyrimet. Agjencia Kundër Korrupsionit, e cila e monitoron përdorimin e listave të pasurisë, i ka sistemuar dhe ruajtur këto të dhëna në një mënyrë që është lehtë e qasshme për palët e interesuara dhe publikun e gjerë. Megjithatë, informatat në lidhje me deklaratimet e pasurisë mund të bëhen publike pas dorëzimit të kërkesës për qasje në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Siç u tha më lart, Agjencia Kundër Korrupsionit është organi i autorizuar dhe vazhdimisht është e angazhuar në monitorimin e pasurisë së zyrtarëve publikë. Në rast të shkeljes së detyrimeve të parapara me ligj nga ana e deputetëve, Agjencia ndërmerr masat e duhura të përcaktuara me ligj.

Po ashtu, kur diskutohet për integritetin në punën e Kuvendit të Kosovës, zbatimi i Kodit të Etikës për Deputetët e Kuvendit padyshim luan një rol të rëndësishëm si mjet efektiv për zbutjen dhe parandalimin e korrupsionit në vend. Kodi në fjalë është pjesë e Rregullores së Kuvendit dhe është lehtë i qasshëm në uebfaqen e Kuvendit. Ky kod përmbledh dhe rregullon çështjet e përdorimit të pronës shtetërore, dhuratave, konfliktit të interesit dhe veprimtarisë politike. Ndërsa Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, ndër të tjera, rregullon Kodin e Etikës dhe Konfliktin e Interesit për deputetët.

Kosova ka investuar një shumë të konsiderueshme parash në fushatën për njohje të reja ndër vite, përveç shpenzimit të parave për probleme të tjera që kanë të bëjnë me imazhin e saj zyrtar. Megjithatë, forma aktuale e lobimit shpeshherë ka ngritur pyetje në lidhje me transparencën e shpenzimeve, përveç se sa janë arritur objektivat. Gjatë vlerësimit të nënkomponentit të Lobimit, Kosova ende nuk e ka një rregullore që do t'i rendiste dhe përcaktonte rregullat e lobimit. Lobimi i rregulluar me legjislacion e përmirëson transparencën e sektorit publik dhe rregullon ndërveprimet mes grupeve të ndryshme të interesit, lobuesve, zyrtarëve publikë dhe politikanëve. Hapi i parë thelbësor në rritjen e llogaridhënies, forcimin e sistemit ligjor për luftimin e korrupsionit dhe rritjen e performancës së administratës shtetërore është hartimi i rregulloreve të përcaktuara për lobimin. Rregullat do t'i përcaktonin edhe aktivitetet legjitime të lobimit duke i dalluar kështu ato që vijnë nga shoqëria civile ose palët e tjera të interesuara.

## TRANSPARENCA (90%)

Vlerësimi i nivelit të transparencës së Kuvendit të Kosovës është realizuar duke i matur treguesit lidhur me informatat organizative, prokurimin publik dhe buxhetin e shtetit. Në përgjithësi, Kuvendi i Kosovës ka performuar mirë në fushën e informatave organizative, të cilat e vlerësojnë cilësinë dhe sasinë e të dhënave rreth mënyrës se si funksionon institucioni. Të gjitha ligjet, ndryshimet e ligjeve, projekt legjislacioni, rregullat, strategjitë dhe raportet e punës janë të disponueshme në uebfaqen zyrtare të Kuvendit. Portali elektronik Sistemi për Monitorimin e Legjislacionit, që iu mundëson individëve të vëzhgojnë se në cilën fazë është secili ligj që është në proces të miratimit, është një mjet tjetër që kontribuon në transparencën e Kuvendit.

Uebfaqja e Kuvendit përditësohet shpesh, agjendat publikohen paraprakisht dhe seancat parlamentare transmetohen rregullisht – gjë që në tërësi e nxit pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin legjislativ, duke e përforcuar kështu rolin e Kuvendit si institucion. Në anën tjetër, masat e ndërmarra për lehtësimin e qasjes jo domosdoshmërisht mund të jenë të njohura për qytetarët, gjë që si rrjedhojë kërkon një qasje më proaktive për ta promovuar punën e Kuvendit. Po ashtu, në vitin 2019, Kuvendi e miratoi Strategjinë për Informim dhe Komunikim për periudhën 2019-2021, e cila i përcakton masat që Kuvendi duhet t'i marrë lidhur me informimin e qytetarëve, komunikimin përmes platformave sociale, duke përfshirë YouTube dhe kanalet televizive si dhe duke e përditësuar uebfaqen.

Sa i përket nën-komponentit të informatave organizative, u vlerësua lart nënshkrimi i Deklaratës së Kuvendit për Transparencë, ku në përputhje me deklaratën, Kuvendi ka zhvilluar Strategjinë për Informim dhe Komunikim në Kuvend (2019-2021). Të gjitha informatat që kanë të bëjnë me komisionet e Kuvendit, deputetët, seancat etj. përditësohen vazhdimisht në uebfaqen e Kuvendit. Rregullorja për Komunikimin me Media dhe Publikun, një nga dokumentet më domethënëse që ka nxjerrë Kuvendi, përcakton norma dhe procese për punonjësit dhe palët e tjera që e ndjekin punën e Kuvendit, me qëllim që të sigurohet komunikimi i duhur dhe efektiv.

Në lidhje me transparencën në prokurimin publik, Kuvendi i Kosovës vazhdon ta mbajë nivelin e transparencës në një nivel të përshtatshëm. Procedurat e prokurimit publikohen në platformën elektronike E-Prokurimi <sup>7</sup>, ndërsa kontratat dhe Planifikimi i Prokurimit publikohen në uebfaqen e Kuvendit. Publikimi i procedurave të prokurimit publik, ofertave dhe rezultateve kryesore të prokurimit përmes portalit shtetëror për prokurimin publik, është në përputhje me Ligjin. Kuvendi i Kosovës po ashtu e ka publikuar me sukses planin përfundimtar të prokurimit, që mund të qaset nga qytetarët e Kosovës.

<sup>7</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>

<sup>8</sup> <https://www.kuvendikosoves.org/shq/raporte/raporte-financiare/>

Kuvendi i Kosovës e publikon buxhetin në uebfaqen e tij dhe ofron më shumë informata të hollësishme financiare lidhur me shpenzimin e tij në baza tremujore dhe vjetore. Këto statistika kanë vazhduar të ofrohen përgjatë vitit të vlerësimit në mënyrë të qasshme dhe të kuptueshme, duke e përforcuar sistemin për t'i dhënë publikut dhe akterëve qasje në informacion në formatet e duhura.<sup>8</sup>

Një rekomandim, që është dhënë edhe në vlerësimin e kaluar, ishte që institucioni në fjalë duhet të fillojë së publikuari të ashtuquajturin 'buxhetin e qytetarëve', me qëllim që të rritet transparenca dhe qasja e qytetarëve në punën e Kuvendit dhe buxhetin e tij. Dokumenti rekomandohet të jetë i shkruar në një format të qasshëm dhe të kuptueshëm në mënyrë që lexuesit jo specialistë të mund t'i kuptojnë informatat. Thjeshtimi i buxhetit të ndërlikuar institucional në një format që kuptohet lehtë do të kontribuonte drejtpërdrejt në rritjen e transparencës fiskale të institucionit.

## ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË AKTIVITETET E KUVENDIT TË KOSOVËS

ODK-ja ka vazhduar bashkëpunimin me UBO Consulting duke hulumtuar përkushtimin dhe mendimet e qytetarëve për punën e Kuvendit të Kosovës. Gjithsej 1306 qytetarë të Republikës së Kosovës u intervistuan përmes metodës së mostrës gjithëpërfshirëse, të ndarë sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, vendbanimit dhe të ardhurave familjare. Anketa vlerësoi angazhimin e qytetarëve me punën e Kuvendit, duke analizuar nëse qytetarët besojnë se interesat e tyre merren parasysh, nëse besojnë se mund të kontribuojnë në zhvillimet e institucionit në fjalë, etj.

Nga sondazhi i realizuar, më shumë se gjysma e pjesëmarrësve nuk mendojnë se mund të kontribuojnë në nismat e Kuvendit të Kosovës.<sup>9</sup> Në anën tjetër, 30.1% e burrave dhe 25.8% e grave të anketuara për këtë çështje mendojnë se mund të kontribuojnë në nismat e Kuvendit të Kosovës.

Pyetja tjetër kishte të bënte me kënaqshmërinë e pjesëmarrësve me punën e Kuvendit të Kosovës.<sup>10</sup> Në përgjithësi, u konstatua që shumica e individëve ishin pak të kënaqur me punën e Kuvendit të Kosovës, ku 39.7% e grave dhe 36.5% e burrave u shprehën kështu. Ndërsa, 5.5% e grave dhe 7.6% e burrave janë shumë të kënaqur me punën e Kuvendit.

Pas këtyre gjetjeve, duhet të theksohet se është e rëndësishme të merren parasysh mendimet e qytetarëve lidhur me punën e Kuvendit dhe që, si pasojë, përpjekjet duhet të drejtohen drejt krijimit të kanaleve të komunikimit që iu mundësojnë qytetarëve të ofrojnë komente për aktivitetet e institucionit.

<sup>9</sup> <https://www.facebook.com/opendatakosovo/posts/pfbid02Ft4LofHcPcLhZdCf1mJ3xxnEjz5DYHKmqSFj2RBzNFBTEEGtjwNP5o6QnddXs9cDI>

<sup>10</sup> <https://www.facebook.com/opendatakosovo/posts/pfbid0GZp3ceujkYS1BnZnZDtNLadothSjvYTqFjK5eiscj9r7eD5yvjad7H79k1WAWqXLI>

# REKOMANDIMET

## HAPAT E VEPRIMIT

Transparenca dhe llogaridhënia njihen gjerësisht si cilësitë themelore të qeverisjes së mirë demokratike. Rekomandimet në vijim dalin nga rezultatet e vlerësimit për Kuvendin e Kosovës:

- *Përforcimi i funksionit përfaqësues të Institucionit përmes themelimit të kanaleve të komunikimit me qytetarët dhe përfshirja e këtyre të fundit në procesin e hartimit të politikave;*
- *Planifikimi i më shumë sesioneve trajnuese për stafin e Kuvendit në fushën e të dhënave të hapura dhe qasjes në dokumente publike;*
- *Të punohet drejt zhvillimit të shërbimeve elektronike;*
- *Fillimi i zbatimit të Sistemit për Peticionin Elektronik (e-peticioni);*
- *Komunikimi i hapur me qytetarët dhe identifikimi i kanaleve të përshtatshme të komunikimit, goftë përmes telefonit, postës elektronike apo mjeteve të tjera;*
- *Publikimi i ‘buxhetit të qytetarëve’, me qëllim të rritjes së transparencës fiskale dhe qasjes së qytetarëve në punën e Kuvendit dhe buxhetin e tij;*
- *Zbatimi i proceseve të vlerësimit të ndikimit rregullativ (RIA) për të ofruar një vlerësim të plotë dhe sistematik të implikimeve të mundshme të rregulloreve të reja dhe më pas të vlerësohet përmbushja e qëllimeve të synuara të rregulloreve;*
- *Të shtyhet përpara Rregullorja për rregullat e lobimit;*
- *Miratimi i Kodit të Mirësjelljes me qëllim të monitorimit të duhur të zbatimit të Kodit të Etikës së deputetëve dhe dënimit të çdo shkeljeje të standardeve;*
- *Publikimi i të ashtuquajturit Buxheti i Qytetarëve, me qëllim të rritjes së transparencës së Kuvendit lidhur me komponentin e Buxhetit të Shtetit;*
- *Finalizimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Kuvend të Hapur 2023-2026, me qëllim të promovimit të kulturës së transparencës dhe ngritjes së llogaridhënies së Kuvendit;*
- *Publikimi i të gjitha informatave apo dokumenteve parlamentare në uebfaqen zyrtare në formate të hapura (Microsoft Excel ose Word).*